

VENDIM
Nr. 96, datë 24.2.1997

PËR PAGESËN E TË PUNËSUARVE TË PORTIT DETAR TË DURRËSIT, TË CILËT DALIN TË PAPUNË SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË RISTRUKTURIMIT TË KËTIJ PORTI

Për të rregulluar pagesat e të punësuarve të portit detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit të tij, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të punësuarit në portin detar të Durrësit, të cilët dalin të papunë gjatë periudhës 1.1.1997 gjer më 1.10.1997, përfitojnë të drejtën e pagesës për një vit me pagën mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por duke mos kaluar shumën 7000 lekë në muaj.

2. Përfitojnë nga ky vendim të punësuarit në portin detar të Durrësit, të cilët kanë qenë të punësuar në këtë ndërmarrje në mënyrë të pandërprerë për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit dhe ndodhen të punësuar në të gjatë periudhës 1.1.1997 gjer më 1.10.1997.

Të drejtën e trajtimit e kanë të punësuarit që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, qoftë edhe përkohësisht, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, nuk kanë tokë të mjaftueshme në pronësi a përdorim, si dhe janë të gatshëm e pranojnë të marrin pjesë në punë të nevojshme publike të organizuara në nivel lokal.

Këta të punësuar përfitojnë të gjitha kompensimet sipas dispozitave në fuqi.

3. Të drejtën e trajtimit nuk e kanë të punësuarit që largohen nga puna për shkaqe që nuk kanë lidhje me zbatimin e projektit të ristrukturimit të portit detar të Durrësit, si dhe ata që janë trajtuar një herë sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994.

4. Fondet financiare për kryerjen e pagesave të punësuarve sipas këtij vendimi, duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore për këta punonjës, do të përballohen nga porti detar i Durrësit.

5. Periudha e trajtimit të të punësuarve sipas këtij vendimi konsiderohet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për të punësuarit e trajtuar me këtë pagesë derdhen të gjitha llojet e kontributeve, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

6. Pagesat kryhen nga zyrat e punësimit të rretheve, duke u mbështetur në një dokumentacion që përcaktohet me udhëzimin të veçantë.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi